KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 2.3.2016, "Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 38, datë 10.3.2016, bëhet korrigjimi si më poshtë.

Kreu IV, pika 1:

Ishte

IV. KONTRATA ME TARIFËN SIMBOLIKE 1 EURO

1. Pasuritë e paluajtshme shtetërore, 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, mund t'u jepen të tretëve me kontrata përdorimi, me tarifën simbolike 1 (një) euro, me vendim, rast pas rasti, të Këshillit të Ministrave.

Bëhet:

1. Pasuritë e paluajtshme shtetërore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në të cilat vlera e propozuar e investimit kalon shumën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, mund t'u jepen të tretëve me kontrata përdorimi, me tarifën simbolike 1 (një) euro, me vendim, rast pas rasti, të Këshillit të Ministrave.